



Datë: 25.06.2025
Numër Protokolli: 5326/2025

A.nr.751/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankeses A.nr.751/2025, të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesi K.Y, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Armend Deskaj nga Prishtina, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16, paragrafin 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 25.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.751/2025, të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesi K.Y.
- II. Detyrohet** Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postarë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet administrative në mënyrë që kërkesën e ankuesit lidhur me kategorizim të pozitës ta procedoj pranë Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi K.Y, (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 29.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike lidhur me sistemimin pozitës së tij në klasën B7.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2308/2025 të datës 29.04.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.1401/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 6959/2025 të datës 10.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pyetësor për identifikimin e sistemeve shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike e dërguar nga ARKEP; Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin e punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve

Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Akt Emërimin e datës 30.06.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar i Lartë për Kualitet të Shërbimeve dhe Infrastrukturë; Kërkesën e datës 24.01.2024 nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike për ARKEP; Vendimin me Nr. 09/216 të datës 14.08.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin plotësues të punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Kërkesën e datë 08.04.2025 drejtuar nga ankuesi tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 11.04.2025 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesin; Emailin e datës 30.01.2024 nga Kryetari i Bordit të ARKEP për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Vendimin me Nr. 09/230 të datës 13.11.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Raportin i dyte i punës datë 0606.2024 i Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Njoftimin e datës 22.04.2024 nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike për rastin e ankuesit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin e ankesës datës 20.05.2025 dhe Autorizimin e datës 07.05.2025; Vendimin me numër protokolli 3951/2025 të datës 11.06.2025 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit; Plotësimin e ankesës datë 24.06.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka gjetur së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 751/2025, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndë rrjedhë kjo gjendje e fakteve:

- Ankuesi është i punësuar në Autoritetin Rregullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare, dhe së i njëjti mbanë pozitën Zyrtar i Lartë për Kualitet të Shërbimeve dhe Infrastrukturë.
- Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132, të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet, e që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
- Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike, si dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023.
- Sipas Raporti të Punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, si sisteme të informimit dhe komunikimit me rëndësi strategjike për Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare janë aprovuar: *Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit (SNMS)*; *Sistemi për Monitorimin e Kualitetit të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike*; *Sistemi për Menaxhimin e Resurseve Frekuencore*; *Sistemi i CERT-it Nacional (KOS-CERT)/Incident Response/Cyber Threat Intelligence*, e në këtë mënyrë edhe pozita e ankuesit është përfshirë në listën e ekspertëve sipas shtojcës 14.4 të ligjit për paga në sektorin publik gjegjësisht në klasën B7.

- Ankuesi me datë 10.11.2023, kishte parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin së pozita e tij duhej të kategorizohej në Klasën tjerët si B4, B5 apo B6.
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më Vendimin A.nr.1401/2023, të datës 05.01.2024, ka aprovuar ankesën e ankuesit dhe çështjen e kthente në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike.
- Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, përmes emailit të datës 22.04.2024, ka njoftuar se ka përfunduar procesi i rishqyrtimit të këtij rasti, duke njoftuar se ky komisioni qëndron prapa vlerësimit fillestar të raportit të parë.
- Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatitur raportin plotësuar me përfshirje e pozitive të tjera të institucioneve të tjera në kuadër të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, raport ky i miratuar sipas Vendimit Nr.09/216 të datës 14.08.2024, të Qeverisë së Kosovës dhe së sipas këtij raporti nuk ka ndryshime lidhur me pozitën e ankuesit, rrjedhimisht nuk është trajtuar fare riklasifikimi i pozitës së ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është trajtuar çështja e tij në mënyrë të drejtë pasi që do të duhej të përfshihej në Klasën B4, sepse ka zyrtarë të tjerë të institucionit të njëjtë që janë përfshirë në këtë klasë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore, thekson faktin së më datë 27.08.2024, ka hy në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, e cila më nenin 11 ka shfuqizuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, ndërsa, në zbatim të kësaj rregullore Qeveria e Kosovës më Vendimin nr. 10/230 të datës 13.11.2024, ka themeluar Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, i cili sipas nenit 7 të rregullores si më sipër ka këto kompetenca: 1. *Komisioni shqyrton dhe vlerëson kërkesat e dërguara nga Zyrtaret Kryesor Administrativ të Institucioneve sipas kësaj Rregulloreje....5. Komisioni është kompetent për trajtimin e kërkesave të reja dhe kërkesave për rishqyrtim nga institucionet, sistemet e të cilave nuk janë përcaktuar si sisteme të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Komisioni gjithashtu është kompetent të rishqyrtojë edhe kërkesat e institucioneve për pozitat e refuzuara në kuadër të sistemeve të përcaktuara si sisteme të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Kërkesat për rishqyrtim duhet të përmbajnë dëshmi të reja për plotësimin e kriterëve të kësaj Rregulloreje”.*

Rrjedhimisht, Rregullorja (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, më nenin 7 paragrafi 4, në mënyrë shprehimore ka përcaktuar: 4. *Kur Komisioni vlerëson se kërkesa nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, i paraqet Qeverisë rekomandim të arsyetuar për mospërfshirjen e sistemit të rrjetit dhe informacionit në listen e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, si dhe mospërfshirjen në listën e pozitive të punës. Kundër vendimit të Qeverisë mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente. Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji vlerëson së duke qenë së pozita e ankuesit është përfshirë në listën e eksperteve, dhe meqenëse ankuesi pretendon në klasifikim jo të drejtë të pozitës së tij, atëherë, kërkesa e ankuesit për rishqyrtim të kategorizimit të pozitës së tij duhet të procedohet në komisionin kompetent nga Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregulltiv për Komunikime Elektronike dhe Postarë, e me pastaj çështja procedohet sipas kërkesave të përcaktuara me nenin 7 paragrafi 4 të Rregullores*

(QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, ku si rrjedhojë Këshilli nuk ka kompetencë që të trajtoj vendimet e komisionit gjegjës të aprovuara nga Qeveria, pasi që në rast kontesti lidhur me vendimet e Qeverisë në raport me rekomandimet e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, mund të iniciohet konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.751/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Armend Deskaj;
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike/MPB;
- Kryetarit të Bordit dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në ARKEP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK -së.